



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

Raporti i Akreditimit Institucional i Universitetit të Arteve

Janar, 2022

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM:

1. Prof. Dr. Anila Hoda Kryetar
2. Prof. Asoc. Dr. Hemion Braho Anëtar

Përmbajtja

| | |
|---|------------------------------|
| Rreth këtij vlerësimi | 4 |
| Konteksti i këtij vlerësimi | 5 |
| Raporti përmbledhës | 7 |
| Përmbledhje e gjetjeve | 11 |
| Praktika e mirë | 11 |
| Pikat e dobëta..... | 11 |
| Rekomandime | 11 |
| Konfirmimi i veprimeve të ndërmarra | 11 |
| Përmbledhje e gjyqimeve për çdo fushë vlerësimi..... | 12 |
| Gjykim i përmbledhur | 12 |
| Fusha e vlerësimit 1: Organizimi dhe menaxhimi i tij..... | 13 |
| Gjetjet..... | 17 |
| Praktika e mirë | 17 |
| Pikat e dobëta..... | 17 |
| Rekomandime | 17 |
| Konfirmimi i veprimeve të ndërmarra | 17 |
| Gjyqimi | 17 |
| Fusha e vlerësimit 2: Burimet | 18 |
| Gjetjet..... | 23 |
| Praktika e mirë | 23 |
| Pikat e dobëta..... | 23 |
| Rekomandime | Error! Bookmark not defined. |
| Konfirmimi i veprimeve të ndërmarra | Error! Bookmark not defined. |
| Gjyqimi | Error! Bookmark not defined. |
| Fusha e vlerësimit 3: Kurrikula | 25 |
| Gjetjet..... | 30 |
| Praktika e mirë | 30 |
| Pikat e dobëta..... | 30 |
| Rekomandime | 30 |
| Konfirmimi i veprimeve të ndërmarra | 30 |
| Gjyqimi | 30 |
| Fusha e vlerësimit 4: Mësimdhënia, të nxënët, vlerësimi dhe kërkimi | 31 |
| Gjetjet..... | 35 |
| Praktika e mirë | 35 |
| Pikat e dobëta..... | 35 |
| Rekomandime | 35 |
| Konfirmimi i veprimeve të ndërmarra | 35 |
| Gjyqimi | 35 |
| Fusha e vlerësimit 5: Studentët dhe mbështetja e tyre | 36 |
| Gjetjet..... | 38 |
| Praktika e mirë | 38 |
| Pikat e dobëta..... | 38 |
| Rekomandime | 38 |
| Konfirmime | 38 |
| Gjyqimi | 38 |
| Lista e evidencave | 39 |
| Lista A: Lista e evidencave:..... | 39 |
| Lista B: Takimet e zhvilluara gjatë vizitës | 45 |

Rreth këtij vlerësimi

Qëllimi kryesor i vlerësimit institucional është të vlerësojë shkallën në të cilën Universiteti i Arteve i përmbush standardet shtetërore të cilësisë në Shqipëri, të cilat hynë në fuqi në vitin 2011. Vlerësimi institucional është procesi i vlerësimit nga grupi i ekspertëve të vlerësimit dhe çdo grup vlerësimi përbëhet nga një ndërthurje e ekspertëve ndërkombëtarë dhe shqiptarë të vlerësimit, të caktuar nga ASCAL-i.

Raportet përkatëse nuk shërbejnë vetëm për akreditimin institucional, i cili bazohet në shkallën e përmbushjes së standardeve nga Universiteti i Arteve, por edhe për t'u ofruar palëve të interesit, qeverisë shqiptare, publikut dhe studentëve informacion lidhur me mënyrën se si përmbushen standardet nga çdo Institucion i Arsimit të Lartë. Ky raport u vjen në ndihmë, gjithashtu, edhe institucioneve të arsimit të lartë që të identifikojnë përparësitë që kanë nevojë për përmirësim (procesit që ofruesit e arsimit të lartë zbatojnë për përmirësimin në mënyrë sistematike të cilësisë së ofrimit dhe mënyrave për mbështetjen e të nxëniet të studentëve).

Standardet shtetërore të cilësisë në Shqipëri janë grupuar në 5 (pesë) krerë, Fusha Vlerësimi: Organizimi dhe Menaxhimi i tij; Burimet; Kurrikula; Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi; si dhe Studentët dhe Mbështetja e tyre. Ky raport identifikon veçoritë e praktikave të mira, rekomandimet, pohimet për veprimet në proces e sipër dhe pikat e dobëta për çdo fushë vlerësimi, duke përfshirë gjykimin lidhur me shkallën e përmbushjes së standardeve nga ana e IAL-së. Format e gjyimit që mund të japin ekspertët janë: standardet janë përmbushur plotësisht; standardet janë përmbushur kryesisht; standardet janë përmbushur pjesërisht; ose standardet nuk janë përmbushur.

Në fund, ekspertët e vlerësimit e përmbyllin punën e tyre duke rekomanduar një gjykim të përmbledhur për Bordin e Akreditimit të ASCAL-it. Ky gjykim i përmbledhur është një nga katër nivelet e mëposhtme:

- **Standardet shtetërore të cilësisë janë përmbushur**
- **Standardet shtetërore të cilësisë janë përmbushur kryesisht**
- **Standardet shtetërore të cilësisë janë përmbushur pjesërisht**
- **Standardet shtetërore të cilësisë nuk janë përmbushur.**

Në kuadrin e procesit të përgatitjes së raportit, ASCAL-i i ka ofruar mbështetje të specializuar gupit të vlerësimit, duke u siguruar që grupi t'i mbështesë gjetjet në raport me fakte, si edhe duke korrigjuar dhe përmbledhur raportin e plotë për përmbledhjen që vijon.

Konteksti i këtij vlerësimi

Universiteti i Arteve (UART) është i vetmi institucion publik i arsimit të lartë me karakter artistik. Universiteti i Arteve përfshin në trashëgiminë e tij përvojën e shkëlqyer të Konservatorit të Muzikës të krijuar në vitin 1962, të Institutit të Arteve të Bukura të krijuar në vitin 1959, dhe të Shkollës së Teatrit të krijuar në vitin 1959. Me bashkimin e këtyre tri institucioneve artistike në vitin 1966 u krijua Instituti i Lartë të Arteve. Më pas, në vitin 1991, ai u emërtua Akademia e Arteve. Universiteti i Arteve, siç njihet sot, u krijua me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 234, datë 23.03.2011. UART-ja është akredituar me vendimin nr. 68, datë 21.09.2017, të Bordit të Akreditimit "Për akreditimin e parë të Institucionit të Arsimit të Lartë "Universiteti i Arteve", me vendim pozitiv me një kohëzgjatje prej 4 (katër) vitesh, me rekomandimet përkatëse. UART-ja gëzon një status të veçantë në përputhje me VKM-në nr. 145, të datës 10.03.2021, "Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Arteve si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e arteve në Republikën e Shqipërisë". UART-ja ofron programe studimi për ciklin e parë (Bachelor) të studimeve, programe studime të ciklit të dytë (Master i Shkencave), "Master i Arteve" dhe "Master Profesional" në fushën e muzikës, artit skenik, si dhe arteve të bukura. Karakterizohet nga roli i tij i fortë në rajon dhe rrjetet lokale.

Universiteti i Arteve përbëhet nga 3 njësi/fakultete kryesore. Çdo fakultet ka në përbërjen e vet tri njësi/departamente bazë:

- Fakulteti i Muzikës.

1. Departamenti i Interpretimit
2. Departamenti i Kantos
3. Departamenti i Kompozicionit-Muzikologjisë-Dirigjimit-Pedagogjisë Muzikore (KMDP)

- Fakulteti i Artit Skenik:

1. Departamenti i Aktrimit - Teori Arti
2. Departamenti i Regjisë - Regji Filmi dhe Televizioni
3. Departamenti i Skenografisë & Koreografisë

- Fakulteti i Arteve të Bukura:

1. Departamenti i Pikturës
2. Departamenti i Skulpturës
3. Departamenti i Arteve të Aplikuara

Në të tri fakultetet e UART-së aktualisht zhvillohen 32 programe studimi, respektivisht të ciklit të parë dhe të dytë të studimeve me kohë të plotë. Në vitin e ri akademik 2021-2022 do të ofrohet një program i ri studimi, Diplomë Bachelor në "Fotografi", duke i shtuar kështu një program më shumë totalit të programeve të studimit të ciklit të parë, duke e çuar në 33 numrin e programeve.

Në auditorët e UART-së aktualisht studiojnë 999 studentë të cilëve u jep mësim një staf pedagogjik prej 294 pedagogësh që i përkasin kategorive si Profesor,

Profesor i Asociuar, Doktor, Asistent, Lektor, nga të cilët 161 janë të angazhuar me kohë të plotë.

Raporti përmbledhës

Raporti i Vetë-vlerësimit (RVV) u hartua nga grupi i punës për vetëvlerësim i përbërë nga përfaqësues nga të gjitha fakultetet e Universitetit të Arteve, si dhe nga një përfaqësues i studentëve. Projektraportet, të mbështetura në raportet e vlerësimit të përgatitura për çdo fushë vlerësimi iu shpërndanë një audience më të gjerë brenda universitetit dhe u kqyrën nga Rektori përpara se t'u jepej forma përfundimtare nga grupi hartues i vetëvlerësimit. Në vitin 2017 UART-së iu dha akreditimi me një kohëzgjatje prej 4 (katër) vitesh, me 3 rekomandimet e mëposhtme:

1. Universiteti i Arteve duhet ta trajtojë si nevojë të ngutshme hartimin dhe zbatimin e një plani për përmirësimin fillestar dhe të vazhdueshëm të mësimdhënies përmes aktiviteteve dhe masave konkrete.

UART-ja ka marrë masa për hartimin e një plani zbatimi për përmirësimin fillestar dhe të vazhdueshëm të procesit mësimor, për kombinimin e stafit të ri me atë me përvojë. Ata po kombinojnë pjesëmarrjen e personelit akademik në veprimtari krijuese artistike, duke alternuar në mënyrë të vazhdueshme mësimdhënien nga fillimi. Në aktivitete të tilla do të ketë trajnime për veprimtarinë krijuese- artistike. Si rrjedhojë, ky rekomandim është përmbushur plotësisht.

2. UART-ja duhet t'i kushtojë vëmendje të menjëhershme dhe të kryejë vlerësimin e kurrikulës së tij akademike që të përfshijë shprehi që lidhen me karrierën artistike.

Universiteti ka ndërmarrë hapa konkretë lidhur me këtë rekomandim. Ai krijoi një grup pune (urdhri nr. 6, datë 30.12.2016, "Për krijimin e një grupi të përbashkët pune për të verifikuar përshtatshmërinë e programeve të studimit të ciklit të parë dhe të dytë në Fakultetin e Arteve të Bukura, Fakultetin e Artit Skenik dhe Fakultetin e Muzikës në Universitetin e Arteve") i cili përgatiti një raport që iu dërgua me letër zyrtare (nr.prot. 6838, datë 10.07.2017) MAS-it. UART-ja e përshtati kurrikulën mësimore për të gjitha programet e studimit të ciklit të dytë (Master), duke përfshirë edhe lëndë të përcaktuara në raportin e grupit të punës, të cilat i përkasin specialitetit të mësimdhënies dhe duke përshtatur titullin e diplomave për të gjitha programet e studimit të ciklit të dytë. Kështu, me qëllim që të jenë sa më afër tregut të punës, programet e ciklit të dytë të studimeve u riorganizuan të gjitha në programe studimi në specialitetin e mesimdhënies. Riorganizimi i tyre u realizua sipas Urdhrit të MASR-së nr. 821, datë 26.12.2018 "Për riorganizimin e programeve të studimit të ciklit të dytë të studimeve në Universitetin e Arteve". Si rrjedhim, ky rekomandim është përmbushur plotësisht.

3. Për të siguruar vazhdimësinë e procesit të mësimdhënies me cilësinë e duhur, UART-ja duhet të marrë masa të menjëhershme për të siguruar

përmbushjen në kohë të detyrimeve ndaj personelit akademik të ftuar në përputhje me detyrimet kontraktuale.

Gjatë takimeve në UART, Bordi i Administrimit bëri me dije se të gjitha pagesat janë shlyer dhe institucioni nuk ka detyrime financiare ndaj stafit të ftuar akademik. Si rrjedhim, ky rekomandim është përmbushur plotësisht.

Grupi i vlerësimit të jashtëm konstatoi që RVV-ja mbështetej në evidenca/prova, dhe më shumë evidenca të synuara iu ofruan grupit përpara dhe gjatë procesit të vlerësimit të jashtëm. Evidencat ishin të disponueshme në gjuhën angleze dhe shqipe. Përgjithësisht, për grupin e vlerësimit të jashtëm RVV-ja ishte një dokument i dobishëm mbi të cilin do të realizonte vlerësimin. Përshkrimi që përmbante raportin për çdo fushë vlerësimi ishte i dobishëm për grupin e vlerësimit për të përcaktuar shkallën e përmbushjes së standardeve nga universiteti; gjithsesi, gjykimet e grupit të vetëvlerësimit të vetë universitetit ishin më pozitive sesa gjykimet e dhëna nga grupi i vlerësimit të jashtëm.

Grupi i vlerësimit të jashtëm zhvilloi një vizitë dyditore në institucion. Ai përbëhej nga dy ekspertë vlerësimi, një ekspert vlerësimi i arsimit të lartë dhe një anëtar stafi me përvojë në arsimin e lartë nga institucione shqiptare dhe të huaja. Grupi i vlerësimit të jashtëm u mbështet nga menaxheri për vlerësimin e jashtëm, i vënë në dispozicion nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë në Shqipëri (ASCAL). Grupi i vlerësimit të jashtëm mori paraprakisht raportin e vetëvlerësimit dhe portofolin me të dhënat mbështetëse të javë përpara vizitës së planifikuar për vlerësimin e jashtëm, i cili u plotësua me dokumentacion shtesë me kërkesë të grupit. Gjithsej, u shqyrtuan 224 dokumente, të cilat i dhanë mundësinë grupit të vlerësimit të njëjtit me strukturën, politikën, procedurat e menaxhimit, si dhe me natyrën e mësimdhënies dhe veprimtarisë kërkimore të ndërmarrë nga institucioni. Këto dokumente mbështetëse përfshinin statutin e UART-së, rregulloret akademike, raportet vjetore, procedurat e pranimit dhe orientimit të studentëve, listën e marrëveshjeve të jashtme, shembujt e informacioneve rreth programeve të ofruara, si dhe dokumentet e mbledhjeve vendimmarrëse.

Një sërë takimesh u zhvilluan gjatë dy ditëve të vizitës në kuadër të vlerësimit të jashtëm, të cilat bënë të mundur që grupi i vlerësimit të jashtëm të kuptonte më qartë përgjegjësitë, procedurat dhe këndvështrimet e stafit dhe të studentëve. Grupi i vlerësimit të jashtëm u takua me Rektorin, menaxherë të nivelit të lartë, studentë, pedagogë, personelin administrativ dhe mbështetës, si dhe partnerë të jashtëm. Në të gjitha takimet e zhvilluara u mbajtën shënime. Si pjesë e vizitës në ambientet e kampusit, grupi i vlerësimit të jashtëm pa bibliotekën, sallat e leksioneve dhe seminareve, laboratorët e teknologjisë së informacionit dhe iu mundësua të shikonin sistemin e informacionit elektronik dhe online të universitetit për stafin dhe studentët. Pas shqyrtimit të të gjitha dokumenteve mbështetëse të

vëna në dispozicion, grupi i vlerësimit të jashtëm arriti në përfundimet e parashtruara më poshtë:

Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë përmbushur **plotësisht** nga universiteti. Përgjegjësitë për organizimin dhe menaxhimin e UART-së përcaktohen qartë në statutet dhe rregulloret e universitetit dhe ekzistojnë komisione të përshtatshme që funksionojnë teksa institucioni punon drejt zbatimit të plotë të legjislacionit të ri. Miratimi i një statuti të ri dhe i një rregulloreje të re institucionale u krye në përputhje me VKM-në nr. 145, datë 10.03.2021 “Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Arteve si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e arteve në Republikën e Shqipërisë”.

Grupi i vlerësimit të jashtëm nuk identifikoi pika të dobëta. Si shembull i një praktike të mirë, grupi i vlerësimit të jashtëm identifikoi vendimmarrjen dhe komunikimin e mirë mes organeve drejtuese të universitetit. Grupi i vlerësimit të jashtëm rekomandoi shtimin e përpjekjeve për t’u bërë njësi artistike lider, duke iu referuar edhe nevojave të tregut. Strategjia e Zhvillimit 2018-2025 ka nevojë për një studim tregu të plotë e tërësor që ky institucion nuk e ka. Së fundi, rrjeti i mirë kombëtar dhe ndërkombëtar i krijuar duhet të shihet si një mundësi për të rritur bashkëpunimin në mënyrë efikase për projekte të veçanta edhe në optikën e diversifikimit të riskut për shkak të pakësimit të të ardhurave nga studentët. Nuk pati pohime të veprimeve të ndërmarra lidhur me këtë fushë vlerësimi.

Standardet për Burimet janë përmbushur **plotësisht** nga institucioni. Universiteti i Arteve ka burime njerëzore të mjaftueshme të kualifikuara dhe të specializuara dhe një strukturë të dedikuar për menaxhimin e burimeve njerëzore. Ai ndjek procedurat ligjore për punësimin dhe emërimin e stafit të vet. Universiteti garanton vënien në dispozicion dhe aksesin të të dhënave të institucionit. Menaxhimi financiar bëhet nga strukturat e përshtatshme që përcaktohen nga ligji përkatës dhe në përputhje me rregullat e administrimit publik financiar. Të dhënave që kanë të bëjnë me administrimin financiar janë në dispozicion të publikut. Aktualisht, Universiteti i Arteve ka probleme financiare për shkak të kostove të larta të arsimit të studentëve dhe për shkak të pasojave ekonomike nga pandemia. Universiteti tashmë ka krijuar sistemet e tij të informacionit për menaxhimin dhe mbajtjen e aktiviteteve të tij, duke garantuar ofrimin e informacionit online për studentët dhe stafin e tij. Infrastruktura logjistike dhe fizike është përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme e kjo duket qartë. Janë bërë goxha përpjekje për të rritur kapacitetet e universitetit lidhur me ndërtimin e godinave të reja akademike dhe përmirësimin e atyre ekzistuese, si dhe për nisjen e procedurave për ndërtimin e kampusit të ri. Grupi i vlerësimit të jashtëm identifikoi si praktikë të mirë iniciativat private të ndërmarra nga menaxherët e artit, por edhe nga vetë profesorët, artistët të cilët i angazhojnë studentët e UART-së në aktivitete shoqërore, kulturore dhe artistike. Nuk u gjetën pika të dobëta, nuk u dhanë as rekomandime.

Standardet për Kurrikulën janë përmbushur **plotësisht** nga institucioni. Programet e studimit janë hartuar në përputhje me udhëzimet për të përmbushur standardet kombëtare të cilësisë, duke respektuar kërkesat e ligjeve dhe akteve nën-ligjore. Programet e studimit janë hartuar duke synuar lehtësimin e mobilitetit të studimeve të studentëve dhe transferimin e studimeve në institucione të tjera të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit. Programet e studimit janë hartuar duke patur parasysh kërkesat e tregut të punës dhe pasqyrojnë fleksibilitetin e këtij tregu. Kurrikula ka objektiva të qarta studimi dhe trajnimi. Programet i nënshtrohen përmirësimeve të vazhdueshme. Në programet e studimit dhe kurrikulat universitare ka vend për përmirësim në aspektin praktik të programeve të studimit sidomos për disa programe studimi dhe diploma për të cilat tregu evoluon më shpejt. Marrëdhëniet e universitetit me palët e treta duhet të jenë më ndërvepruese dhe të qëndrueshme. Si një pohim i marrë, UART-ja ka aplikuar në MASR për hapjen e programeve të ciklit të tretë, Doktor në Muzikologji dhe Doktor në Artet Skenike, por nuk është marrë ende një miratim zyrtar nga MASR. Grupi i vlerësimit të jashtëm nuk identifikoi pika të dobëta apo tipare të praktikës së mirë. Grupi i vlerësimit të jashtëm rekomandon përmirësimin e bashkëpunimit me të diplomuarit (alumni) dhe partnerët e jashtëm, me qëllim që të vihet theksi tek ide dhe programe që sjellin risi, të cilat mund të ndihmojnë në rritjen e mëtejshme të cilësisë së UART-së dhe konkurrueshmërisë së saj në treg.

Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë përmbushur **plotësisht** nga institucioni. Tipari i ndërkombëtarizimit të UART-së po zbatohet përmes pjesëmarrjes së stafit dhe kërkuesve shkencorë në aktivitete artistike, simpoziume, seminare, ekspozita, etj. Grupi i vlerësimit të jashtëm identifikoi si praktikë të mirë punësimin e studentëve brenda vendit dhe jashtë tij në institucione prestigjioze në fushën e artit dhe kulturës. GVJ-ja nuk identifikoi pika të dobëta e nuk dha as rekomandime. GVJ-ja pohoi se krijimi i Zyrës Alumni do të krijojë mundësi më të mëdha për sigurimin e të dhënave të sakta lidhur me cilësinë e programeve të studimit.

Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë përmbushur **plotësisht** nga institucioni. Pranimi i studentëve në programet menaxhohet në pajtim me statutin dhe rregulloret dhe studentëve iu është mundësuar aksesimi në informacione të qarta lidhur me programet e studimit dhe shërbimet që ofron ky universitet. Një nivel i mirë mbështetjeje u ofrohet studentëve nga personeli akademik dhe administrativ, duke përfshirë këshillimin e karrierës. Këshilli Studentor është krijuar dhe është funksional me pjesëmarrjen e studentëve në qeverisjen e institucionit. GVJ-ja identifikoi si praktikë të mirë aktivitetet e përbashkëta të studentëve dhe personelit akademik, të tilla si koncerte, shfaqje baleti, ekspozita të arteve të bukura etj. Nuk u identifikuan pika të dobëta, nuk bënë rekomandime e nuk pati as konfirmime të veprimeve të ndërmarra.

Përmbledhje e gjetjeve

Praktika e mirë

Grupi i vlerësimit të jashtëm identifikoi si shembuj të praktikës së mirë:

- Vendimmarrjen dhe komunikimin e mirë mes organeve drejtuese të këtij universiteti **[Kreu III, Standardi I.2]**
- Iniciativat private të ndërmarra nga menaxherët e artit, por edhe nga vetë profesorët, artistët të cilët i angazhojnë studentët e UART-së në veprimtari shoqërore, kulturore dhe artistike **[Kreu III, Standardi IV.4]**
- Punësimin e studentëve brenda vendit dhe jashtë tij në institucione prestigjioze në fushën e artit dhe kulturës **[Kreu I, Standardi II.3]**
- Veprimtaritë e përbashkëta të studentëve dhe personelit akademik, të tilla si koncerte, shfaqje baleti, ekspozita të arteve të bukura, etj. **[Kreu I, Standardi III.7].**

Pikat e dobëta

Nuk u identifikuan pika të dobëta nga grupi i vlerësimit të jashtëm:

Rekomandime

Grupi i vlerësimit të jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- Të shtohen përpjekjet për t'u shndërruar në njësi artistike lider, duke iu referuar edhe nevojave të tregut. **[Kreu III, Standardi I.5].**
- Strategjia e Zhvillimit 2018-2025 ka nevojë për një studim tregu te plotë e tërësor që ky universitet nuk e ka **[Kreu III, Standardi III.1].**
- Rrjeti i mirë kombëtar dhe ndërkombëtar i krijuar duhet parë si një mundësi për rritjen në mënyrë efektive të bashkëpunimit për projekte specifike edhe në optikën e diversifikimit të riskut për shkak të pakësimit të të ardhurave nga studentët. **[Kreu III, Standardi III.2, Kreu III, Standardi III.3, Kreu III, Standardi III.4].**
- Edhe pse institucioni ka një komunikim dhe bashkëpunim të mirë me të diplomuarit (alumni) dhe partnerët e jashtëm, bashkëpunimi me këta të fundit mund të përmirësohet më tej me qëllim që fokusi të jetë te idetë dhe programet më inovative të cilat mund të ndihmojnë në rritjen e mëtejshme të cilësisë dhe konkurrueshmërisë së UART-së. **[Kreu I, Standardi I.2].**

Konfirmimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i vlerësimit të jashtëm pohoi veprimet e mëposhtme tashmë në proces e sipër:

- Projekti i ndërtimit të një kampusi të ri universitar në hapësirën aktuale të universitetit është në pritje të miratimit ndërkohë punimet pritet të fillojnë menjëherë pas miratimit. **[Kreu III, Standardi, VII.3].**
- UART-ja ka aplikuar në MAS për hapjen e programeve të ciklit të tretë, Doktor në Muzikologji dhe Doktor në Artet Skenike, por nuk është marrë ende miratimi zyrtar nga MAS. **[Kreu I, Standardi I.1].**
- Krijimi i Zyrës Alumni do të krijojë mundësi më të mëdha për krijimin e të dhënave të sakta lidhur me cilësinë e programeve të studimit. **[Kreu I, Standardi II.3]**

Përmbledhje e gjyqimeve për çdo fushë vlerësimi

Standardet për organizimin dhe menaxhimin e tij janë **përbushur plotësisht.**

Standardet për burimet janë **përbushur plotësisht.**

Standardet për kurrikulën janë **përbushur plotësisht.**

Standardet për mësimdhënien, të nxënit, vlerësimin dhe kërkimin janë **përbushur plotësisht.**

Standardet për studentët dhe mbështetjen e tyre janë **përbushur plotësisht.**

Gjykim i përmbledhur

Grupi i vlerësimit të jashtëm i rekomandon Bordit të Akreditimit se në Universitetin e Arteve standardet shtetërore të cilësisë janë **përbushur plotësisht.**

Fusha e Vlerësimit 1: Organizimi dhe menaxhimi i institucionit

- 1.1 Universiteti i Arteve (UART) është institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë me karakter artistik në Shqipëri. Universiteti i Arteve përfshin në trashëgiminë e tij përvojën e Konservatorit të Muzikës të krijuar në vitin 1962, Institutit të Arteve të Bukura të krijuar në vitin 1959, Shkollës së Teatrit të krijuar në vitin 1959. Me bashkimin e këtyre tri institucioneve artistike në vitin 1966 u krijua Instituti i Lartë të Arteve. Në vitin 1991, ai u emërtua Akademia e Arteve. Universiteti i Arteve u krijua me vendim të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 234, datë 23.03.2011 **(F1.1; F1.8)**. Statuti është përmirësuar dhe përshtatur me qëllim që të jetë në përputhje me ligjin dhe aktet nënligjore në fuqi, veçanërisht me VKM-në nr. 145, të datës 10.03.2021, “Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Arteve si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e artit në Republikën e Shqipërisë” **(F1.1; F1.3)**. Statuti i rishikuar përcakton misionin e institucionit, strukturat e organizimit të brendshëm dhe menaxhimit. Në të njëjtën kohë, ai vërteton që institucioni ndërmerr veprime në kohë për t’iu përgjigjur kërkesave të ligjit, në përputhje me vizitën e grupit të vlerësimit në 2017 (Vendim i Bordit të Akreditimit (VBA) nr. 68, datë 21.09.2017). UART-ja përpiloi një rregullore të brendshme të re në përputhje me “statusin e veçantë” të ri që mori dhe Senati e miratoi pak para se grupi i vlerësimit të jashtëm të bënte vizitën në institucion. **(F1.2)**. *[Kreu III, Standardi I.1]*.
- 1.2 Universiteti i Arteve ka 3 njësi/fakultete kryesore. Çdo fakultet ka në përbërjen e vet tri njësi/departamente bazë. Në të tri fakultetet e UART-së aktualisht zhvillohen përkatësisht 33 programe studimi për ciklin e parë dhe 31 për ciklin e dytë (27 “Master i Arteve” dhe 4 “Master Profesional”) të studimeve me kohë të plotë. UART-ja nuk ofron programe studimi të ciklit të tretë. Institucioni e ka vënë në dijeni grupin e vlerësimit të jashtëm lidhur me dy programe doktorature dhe është në pritje të një përgjigjeje nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve (MAS). Njësitë më vete drejtohen nga dekanët e zgjedhur të fakulteteve dhe përgjegjësit e departamenteve. Fakultetet dhe departamentet kanë rregulloret e tyre që rrjedhin nga statutet dhe rregulloret e UART-së. Statuti dhe rregullorja e këtij institucioni përcaktojnë strukturën dhe organizimin e UART-së i cili përqendrohet në organet e mëposhtme kyçe: Senati Akademik, Bordi i Administrimit, Rektorati, Dekanati, Këshilli i Etikës dhe Komisionet e Përhershme **(F1.1; F1.2; F1.3; F1.4; F1.8; F1.9; F1.10)**. Statuti **(F1.1)** përcakton detyrat kryesore të Senatit Akademik i cili, përpos përgjegjësisë së jetës akademike, në përputhje me ligjin, miraton paraprakisht buxhetin vjetor dhe atë të mes-semestrit, i cili padyshim miratohet nga Bordi i Administrimit. Senati Akademik duhet të mbledhet të paktën njëherë në muaj, me qëllim që të diskutojë çështjet institucionale që lidhen me jetën akademike apo çështje financiare. Senati ka rregulloren e vet **(F1.10)**. I kryesuar nga rektori, ai është autoriteti më i lartë akademik i institucionit dhe përfshin përfaqësues të

zgjedhur nga stafi dhe studentët. Rektorati është përgjegjës për hartimin e politikave financiare dhe të zhvillimit strategjik të institucionit bazuar në nevojat e fakulteteve pjesë përbërëse të tij, të departamenteve dhe ato të parashikuara në Planin Strategjik **(F1.1)**. Ato paraqiten para Senatit, i cili i diskuton dhe i përdor si bazë për përgatitjen e projekt-buxhetit vjetor. Ky proces mbështetet nga një njësi e re e emërtuar Sektori i Financës dhe i Ekzekutimit të Buxhetit. Ky i fundit, sipas kërkesave të Njësive Bazë dhe Kryesore, përpilon projektbuxhetin. Bordi mbikëqyr çështjet financiare dhe administrative dhe bashkëpunon me Senatin dhe Rektoratin për të hartuar planet për buxhetet dhe burimet bazuar në mundësitë dhe inputet financiare konkrete të njësive akademike më vete **(F1.6; F1.7; F2.13)**. Siç u konfirmua gjatë takimeve, nuk janë hasur vështirësi të veçanta me vendimmarrjen dhe komunikimin mes organeve drejtuese të këtij institucioni. Gjithsesi, nevojat financiare të institucionit janë më të mëdha se ç'mund të përballojë institucioni me mjetet financiare që zotëron aktualisht **(BM9; BM10)**. Kjo vjen për shkak të numrit të kufizuar të studentëve dhe kostove për përgatitjen e studentëve në disiplina të përkatëse të artit. **[Kreu III, Standardi I.2]**.

- 1.3 Për monitorimin dhe vlerësimin e brendshëm të cilësisë, fakultetet e UART-së kanë krijuar grupe pune për çdo fakultet. Këto grupe monitorojnë kufijtë e autonomisë akademike dhe administrative. Ato vlerësojnë efektshmërinë e mësimdhënies dhe veprimtarive kërkimore/artistike të institucionit **(F1.11; F1.12; F1.13)**. Detyrat e këtyre njësive janë të përcaktuara qartë dhe të ndara. Autonomia financiare garanton të drejtën për të gjeneruar të ardhura të ligjshme nga veprimtaritë e mësimdhënies dhe veprimtaritë përkatëse shkencore-kërkimore-artistike. Struktura e UART-së lejon përfitimin e fondeve nga buxheti i shtetit dhe organizata të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe përdorimin e këtyre të ardhurave sipas veprimtarisë dhe nevojave të institucionit **(A.1.18, A.1.20)**. UART-ja pohon se institucioni nuk ka punësuar këshilltarë të jashtëm që t'i ofrojnë ndihmë për funksionimin e duhur të tij **(RVV fq.15)**. Gjatë vizitës u pohua se kjo është pasojë e politikës së universitetit me qëllim përfshirjen e këtyre ekspertëve në jetën e brendshme akademike nëpërmjet roleve të ndryshme, si psh. si lektorë të ftuar apo lektorë me kohë të pjesshme, me iniciativa/projekte të veçanta, etj. **(BM2)**. **[Kreu III, Standardi I.4]**.
- 1.4 Në planin e tij strategjik (2018-2025) universiteti është angazhuar për "ndërkombëtarizimin" veçanërisht në tregun European **(F1.14)**. Plani strategjik i zhvillimit synon ta transformojë UART-në në një komunitet të fuqishëm, autonom dhe të integruar studentësh, pedagogësh, artistësh dhe kërkuesish të rinj. Universiteti i Arteve synon të mbetet qendra më e madhe dhe me cilësinë më të lartë e arsimit universitar, pasuniversitar, artistike, me veprimtari kërkimore dhe trajnim për përgatitjen profesionale të specialistëve në fushën e artit. Duke ndërthurur arsimin me punën kërkimore dhe projektet artistike, ky

institucion synon të përgatisë jo vetëm artistë të kualifikuar, por edhe qytetarë të përgjegjshëm në shërbim të shoqërisë. Plotësimi i ofertës së studimeve me programet e ciklit të tretë do të krijonte një mundësi shumë të mirë për formimin e studenteve në fushën e artit. Sipas strategjisë, Universiteti i Arteve do të mbështetet gjithnjë e më shumë në tri shtylla kryesore të cilat janë: arsimit; krijueshmëria artistike dhe kërkimi shkencor; prodhimi artistik dhe menaxhimi i tij. Plani strategjik i UART-së ka përcaktuar synimet e tij dhe skenarët e mundshëm të zhvillimit për pesë vitet në vijim, që duket se përkojnë me punën që po bën ky institucion, sidomos në lidhje me “skenarin e ndërkombëtarizimit”. Kjo strategji është diskutuar gjerë e gjatë sipas qasjes nga poshtë- lart në hartimin e saj, duke nisur nga departamentet **(BM9)**. Siç u konfirmua gjatë takimit me të diplomuarit dhe partnerët e jashtëm të UART-së, duhet të bëhen më shumë përpjekje që ky institucion të kthehet në një njësi artistike lider duke iu referuar nevojave të tregut. Kjo do të thotë që potenciali i këtij institucioni nuk është realizuar plotësisht. Ky potencial mund të shprehet nëpërmjet modaliteteve të ndryshme, të tilla si krijimi i një “njësie kërkimore”, krijimi i një “reviste shkencore”, kurse të reja në përputhje me nevojat e tregut (dialektet e gjuhës, programe humoristike), krijimi i një kalendari artistik vjetor për të shfrytëzuar plotësisht potencialin e institucionit për infrastrukturën, etj. **[Kreu III, Standardi I.5].**

- 1.5 UART-ja ka në përbërjen e tij tri njësi/fakultete kryesore, ku çdo fakultet përbëhet nga tri njësi/departamente bazë:

Fakulteti i Muzikës (FM):

Departamenti i Interpretimit

Departamenti i Kantos

Departamenti: Kompozicion -Muzikologji-Dirigjim-Pedagogji Muzikore

Fakulteti i Artit Skenik (FAS):

Departamenti i Aktrimit – Teori Arti

Departamenti i Regjisë – Regji Filmi dhe Televizioni

Departamenti i Skenografisë & Koreografisë

Fakulteti i Arteve të Bukura (FAB)

Departamenti i Pikturës

Departamenti i Skulpturës

Departamenti i Arteve të Aplikuara

Stafi i brendshëm akademik në total përbëhet nga 161 lektorë. 98 profesorë kanë tituj akademikë dhe grada akademike (61%), kurse 63 lektorë janë Asistentë Profesorë (39%). UART-ja përcakton numrin e përgjithshëm të stafit bazuar në nevojat e tij vjetore dhe, nëse është e nevojshme, mund të punësojë staf të ri nëpërmjet procedurave transparente të cilat publikohen, gjithashtu, online **(F2.1; F2.2; F2.4)**. Kriteret e detajuara për përzgjedhjen e pedagogëve të ftuar përcaktohen në varësi të programit që do të mbulojnë. **[Kreu III, Standardi II.1]**

- 1.6 UART-ja i dorëzon Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve (MAS) raportin vjetor të veprimtarisë mësimdhënëse, kërkimore, shkencore dhe financiare për çdo vit akademik. Raporti i analizës së mësimdhënies i UART-së hartohet mbi bazën e rezultateve të përftuara nga çdo njësi kryesore. Raporti vjetor është një pasqyrë e përgjithshme e veprimtarisë akademike dhe financiare, hartuar nga Universiteti i Arteve, Tiranë **(F1.15)**. Bordet dhe këshillat mbledhen zyrtarisht rregullisht dhe infomacioni lidhur me pikat e axhendës i vihet paraprakisht në dispozicion të gjithë stafit në mënyrë elektronike. **(F1.7; F1.8)** Studentët dhe stafi vërejtën se çështjeve të ngritura prej tyre u kushtohet vëmendja e duhur përmes debatit konstruktiv në të gjitha komisionet e ngritura në mënyrë zyrtare **(BM3; BM4)**. Përgatitjet për procesin e komisioneve të ndryshme dhe sigurimi i diskutimit dhe debatit kolegial kuptohen nga stafi dhe studentët. UART-ja ka krijuar një këshill etike **(F5.15)**. Dekanët dhe përgjegjësit e departamenteve janë përgjegjës për monitorimin në fushat respektive, zbatimin e vendimeve të marra nga bordet dhe këshillat e formuar në mënyrë zyrtare. **[Kreu III, Standardi I.3; Kreu III, Standardi I.6; Kreu III, Standardi II.3]**.
- 1.7 Në përputhje me Strategjinë e tij të Zhvillimit të Institucionit për periudhën kohore 2018-2025 **(F1.14)** institucioni bën vëzhgimin e tregut për të përmbushur misionin e tij. Ai ka parashikuar përfshirjen e disa partnerëve dhe aktorëve rajonalë, si psh. palët e interesit, bizneset, institucionet publike dhe private, ose punëdhënësit që punësojnë studentët e tij **(F1.18; F1.19; F1.20)**. Bashkëpunimi i partnerëve ka bërë të mundur që institucioni të mbledhë informacione të rëndësishme dhe të jetë në kontakt me tregun. Megjithatë, miratimi i Strategjisë së Zhvillimit 2018-2025 ka nevojë për një studim të plotë tregu, gjë që universiteti nuk e ka bërë. Me qëllim që të jenë sa më afër tregut të punës, të gjitha programet e studimit të ciklit të dytë u riorganizuan në programe studimi në fushën e mësimdhënies. Riorganizimi i tyre u krye sipas urdhrorit të MASR nr. 821, datë 26.12.2018 "Për riorganizimin e programeve të studimit të ciklit të dytë në Universitetin e Arteve". **(F1.17)**. Gjatë takimit, të diplomuarit (Alumni) konfirmuan kontaktin e tyre të vazhdueshëm me Universitetin dhe se punësimi lokal i të diplomuarve është i rëndësishëm, ndërkohë që shumë prej shokëve/shoqeve të tyre të klasës janë shpërngulur diku tjetër brenda vendit ose kryesisht jashtë shtetit **(BM11)**. **[Kreu III, Standardi III.1]**.
- 1.8 Në përputhje me rolin e tij si institucioni i vetëm publik që kontribuon për edukimin artistik dhe zhvillimin e artit dhe në përputhje me Strategjinë e tij të Ndërkombëtarizimit, UART-ja ka nënshkruar marrëveshje të shumta me partnerë biznesi dhe kolegë në sektorë të ndryshëm **(F1.18; F1.19; F1.20)**. Si pasojë, institucioni ka krijuar rrjete të jashtme që ia vlejné dhe u ka ofruar personelit dhe studentëve mundësinë për të marrë pjesë në veprimtari të jashtme edhe në nivel ndërkombëtar **(A 3.21)**. Personeli i nivelit të lartë e di vlerën e qw ka pjesëmarrja e stafit dhe studentëve në aktivitete ndërkombëtare,

si edhe vlerën e studentëve të huaj që e vizitojnë ose që studiojnë në UART **(F3.23)**. Gjatë vizitës u përmend sidomos vlera e shtuar e programit Erasmus+. Institucioni ka një rrjet të mirë në nivel kombëtar sidomos në optikën e sigurimit të ambienteve për studentët. Rrjeti i mirë kombëtar dhe ndërkombëtar i krijuar duhet të shihet si mundësi për të rritur në mënyrë efikase bashkëpunimin për projekte të veçanta edhe në optikën e diversifikimit të riskut për shkak të të ardhurave të pakësuara nga studentët. **[Kreu III, Standardi III.2, Kreu III Standardi III.3, Kreu III, Standardi III.4]**

Gjetjet

Praktika e mirë

Grupi i vlerësimit të jashtëm identifikoi praktikën e mirë të mëposhtme:

- Vendimmarrja e mirë dhe komunikimi mes organeve drejtuese të universitetit **[Kreu III, Standardi I.2]**.

Pikat e dobëta

Grupi i vlerësimit të jashtëm nuk identifikoi pika të dobëta.

Rekomandime

Grupi i vlerësimit të jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- Të shtojë përpjekjet për t'u bërë një njësi artistike lider, duke iu referuar nevojave të tregut. **[Kreu III, Standardi I.5]**.
- Strategjia e Zhvillimit 2018-2025 ka nevojë për një studim tregu të plotë e tërësor që universiteti nuk e ka **[Kreu III, Standardi III.1]**.
- Rrjeti i mirë kombëtar dhe ndërkombëtar i krijuar duhet të shihet si një mundësi për shtimin e bashkëpunimit në mënyrë efikase lidhur me projekte specifike, edhe në optikën e diversifikimit të riskut për shkak të pakësimit të të ardhurave nga studentët. **[Kreu III, Standardi III.2, Kreu III, Standardi III.3, Kreu III, Standard III.4]**

Konfirmim i veprimeve të ndërmarra

Grupi i vlerësimit të jashtëm nuk pati pohime për veprime të ndërmarra për këtë fushë vlerësimi.

Gjykimi

Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë përmbushur plotësisht.

Fusha e vlerësimit 2: Burimet

- 2.1 Në bazë të një organograme të miratuar paraprakisht, një numër i konsiderueshëm punonjësish janë të angazhuar për administrimin dhe funksionimin e Universitetit të Arteve. **(F1.2; F2.1; F2.2; F2.3; F2.4)**. Në këtë universitet punon personeli akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme dhe stafi administrativ në nivel qendror dhe në njësitë kryesore të tij. Ekzistencën e potencialeve të tilla e vërteton sasia e madhe e evidencave dhe të dhënave sasiore **(F1.4; F1.5; F2.1; F2.2; F2.3; F2.4)**. Universiteti kryesisht ka ndjekur një politikë të hapur për rregulloret e rekrutimit dhe garanton konkurrencë të ndershme ndërmjet kandidatëve që plotësojnë kërkesat e përcaktuara për vendet e lira të punës në lidhje me stafin akademik. Kërkesat e rekrutimit fillimisht përcaktohen nga njësitë bazë dhe kryesore, ndërsa proceset e rekrutimit kryhen nga departamenti i BNJ-sw në nivel universitar, bazuar në procedura dhe rregulla të pasqyruara në rregulloret kryesore të universitetit dhe aktet e tjera rregullatore **(F1.2; F2. 1; F2.2; F2.3; F2.4)**. Bazuar në ngarkesën e ligjërimit dhe akademike, nga njësitë bazë dhe kryesore angazhohet personel akademik vizitor dhe nevojat për një staf të tillë miratohen çdo vit nga rektorati i universitetit. Procesi dhe procedurat e përzgjedhjes kryhen në përputhje me kriteret e zbatueshme për personelin akademik të ftuar në universitet, të parashikuara në rregulloren e brendshme të universitetit dhe në përputhje edhe me ligjin nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë”, i ndryshuar, në Republikën e Shqipërisë. Punësimi i stafit ndihmës- akademik gjithashtu i nënshtrohet procedurave dhe rregullave të mirëpërcaktuara dhe të miratuara nga universiteti, bazuar në nevojat e përcaktuara nga njësitë bazë dhe kryesore apo edhe nga departamente të tjera të brendshme të universitetit **(F1.2; F2.1; F2.2; F2.3; F2.4)**. **[Kreu III, Standardi IV.1]**.
- 2.2 Stafi që punësohet në UART, i cili punon me kohë të plotë apo edhe të pjesshme, pavarësisht nëse është akademik, administrativ apo asistent akademik, ka shansin të ndihet i integruar dhe madje të vetëkontribuojë në veprimtarinë e universitetit. Në mënyrë që kjo të përmbushet, universiteti ka një strategji të përgjithshme zhvillimi, e cila zbatohet edhe përmes politikave të rekrutimit dhe punësimit **(F1.14)**. Universiteti e integron stafin në jetën sociale të komunitetit dhe në aktivitete të ndryshme të organizuara nga Universiteti i Arteve, në rajon dhe më gjerë **(A 2.5; F4.13)**. **[Kreu III Standardi IV.2]**.
- 2.3 Në përgjithësi, universiteti ndjek një politikë të zhvillimit të aftësive për stafin akademik dhe asistent akademik. Për ta mbështetur këtë proces ka vënë në dispozicion ambientet e tij. Ai mbështet organizimin e veprimtarive artistike dhe kulturore, fton në universitet staf të kualifikuar akademik dhe profesional **(F2.12, 3.16)**. Universiteti aktualisht nuk ka programe ekzistues studimi që i përkasin nivelit të tretë, por dy programe të studimeve doktorale janë në fazën

përfundimtare procedurale dhe presin përgjigje nga Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS). Një shumëllojshmëri aktiviteteve artistike, shkencore, kulturore nga stafi i UART-së në bashkëpunim ose jo edhe me studentë gjenden të detajuara në Analizën Vjetore të Punës **(F1.15)**. **[Kreu III, Standardi IV.3]**.

2.4 Për shkak të natyrës së specialiteteve të tyre, punonjësit e Universitetit të Arteve përfshihen në veprimtari shoqërore. Ka disa evente të këtij lloji si në aktivitete periodike (sezon koncertesh, ekspozita, shfaqje artistike etj.), ashtu edhe në aktivitete të përbashkëta me institucionet vendase, seminare, tryeza të rrumbullakëta, orë mësimore me profesionistë të fushës “master-klasat”, në bashkëpunim me artistë shqiptarë dhe të huaj. Si shembull të praktikës së mirë në këtë drejtim mund të përmendim iniciativat private të menaxherëve të artit, por edhe nga vetë pedagogët, artistë që angazhojnë studentët e UART-së në veprimtari shoqërore, kulturore dhe artistike **(F2.5; F4.13)**. Institucioni ka ndjekur politika bazuar në legjislacionin në fuqi, për sigurimet e jetës dhe shëndetit. Është hartuar Rregullorja për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin (MZSH) **(F2.6)**. **[Kreu III, Standardi IV.4]**.

2.5 Bazuar në Statutin e Universitetit të Arteve dhe rregulloret e brendshme dhe njësitë kryesore, institucioni ka të ngritur një strukturë të përshtatshme të cilës i është ngarkuar detyra të monitorojë burimet njerëzore dhe aftësitë e potencialit akademik që i përkasin personelit akademik dhe asistent akademik. Personeli akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme, ose instruktorët e ftuar janë përgjithësisht personalitetet më të spikatura në këtë fushë. Janë emra të njohur nëpër fushat ku operojnë si muzikantë, piktorë, skulptorë, regjisorë teatri, filmi e televizioni, aktorë, scenografë dhe koreografë, me njohuri të gjera teorike dhe praktike **(F2.7; F2.8; F2.9; F2.10; F2.11; F2.12)**. Ndërkohë, struktura e BNj-së duket se është më së shumti një strukturë e fokusuar në anën burokratike të procedurave të rekrutimit sesa në rritjen dhe zhvillimin e aftësive potenciale që mund të ketë personeli akademik **(BM6)**. **[Kreu III, Standardi II.2]**.

2.6 Universiteti harton çdo vit buxhetin e tij financiar. Bordi i Administrimit të Universitetit është përgjegjës për hartimin e buxhetit financiar, monitorimin e buxhetit dhe zbatimin e tij. Hartimi i Buxhetit bazohet në kërkesat e paraqitura nga Njësitë dhe strukturat e UART-së. Prioriteti kryesor i Bordit është të sigurojë vazhdimësinë financiare të të gjitha strukturave të Universitetit. Aktualisht, universiteti nuk shfaq ndonjë shqetësim, edhe pse vlerat e larta të kostove për përgatitjen e studentëve në disa fakultete mbeten të larta. Procesi i buxhetimit që ndiqet nga UART kryhet në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë **(F1.7)**. Buxheti përgatitet në

përputhje me njësitë bazë dhe kryesore, dhe departamentet në secilin fakultet përcaktojnë kërkesat themelore për buxhet si dhe janë njësitë menaxhuese të buxhetit **(BM9, BM10)**. **[Kreu III, Standardi VI.1]**.

- 2.7 Administratori i universitetit ka përgjegjësinë kryesore për zbatimin e politikës financiare. Strukturat e dedikuara për zbatimin e politikave financiare dhe zbatimin e buxhetit të universitetit janë nën përgjegjësinë e administratorit. Për të zbatuar dhe përmbushur detyrat e ngarkuara nga Bordi i Akreditimit, Universiteti i Arteve ka pasur dhe ka aktualisht disa projekte investimi për rritjen e kapaciteteve mësimdhënëse dhe akademike, si dhe për përmirësimin e cilësisë së funksionimit të kapaciteteve ekzistuese. Çdo vit, raporti financiar vjetor i universitetit shqyrtohet nga Bordi i Administrimit dhe Senati Akademik. **(F1.1; F1.7; F2.15; F4.12)**. **[Kreu III, Standardi VI.2]**.
- 2.8 Institucioni i nënshtrohet rregullisht procedurave të auditimit të brendshëm. Për shkak të rikonstruksionit të Godinës Kryesore (filluar në korrik 2019 dhe përfunduar në shtator 2020), si dhe rikonstruksionit të Sallës së Koncerteve (aktualisht në vazhdim), auditimi financiar mund të kryhet në një periudhë të mëvonshme. Si universitet publik, vetë institucioni i nënshtrohet auditimit nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit. UART raporton në mënyrë periodike në MAS mbi pasqyrat financiare vjetore **(F2.15)**. Gjetjet përfundimtare nga institucionet monitoruese analizohen dhe shqyrtohen nga organet drejtuese të UART, ndërsa opinionet dhe vendimet përfundimtare të tyre në lidhje me auditimet e kryera bëhen transparente **(BM10)**. **[Kreu III, Standardi VI.3]**.
- 2.9 UART-ja garanton akses të lirë ndaj informacionit për të gjitha strukturat e tij. Të gjitha njësitë bazë dhe kryesore marrin informacionin përkatës në lidhje me të gjitha vendimet, ndryshimet në aktet normative ose në legjislacion dhe organizimin e strukturave drejtuese. Njësitë kryesore garantojnë gjithashtu bashkëpunimin mes tyre dhe ky informacion garantohej edhe nga statuti dhe rregullorja e UART-së **(F1.1; F1.2)**. Në organogramën e universitetit është edhe një njësi përgjegjëse për organizimin dhe funksionimin e sistemeve të informacionit. Në nivel universitar është një specialist përgjegjës për shpërndarjen dhe mirëmbajtjen e sistemit të informacionit **(MB6)**. Në universiteti funksionon tashmë një sistem i mirë informimi pedagogjik dhe mësimor, i cili garanton akses për të gjithë studentët dhe punonjësit e universitetit në të dhënat përkatëse të informacionit që lidhen me oraret mësimore, ndjekjen e leksioneve dhe seminareve, provimet, trajtimin konfidencial të notave, vlerësimin dhe të dhëna të tjera që kanë të bëjnë me regjistrimin dhe përmirësimin e mëtejshëm të aktiviteteve akademike **(F4.5; F4.9; F5.7)**. Deri në shtator 2021, sistemi ESSE3 përdorej për menaxhimin e studimeve dhe kurrikulave, tashmë i zëvendësuar nga sistemi PITAGORA **(RVV, 31)**. Institucioni publikon në faqen zyrtare të internetit të gjithë

informacionin e nevojshëm mbi ofertën akademike, organizimin dhe funksionimin e institucionit, statutin dhe rregulloret e funksionimit të tij. Nëpërmjet sistemeve të informacionit dixhital studentët kanë mundësinë të ndjekin në kohë reale informacione lidhur me procesin mësimor, veprimtarinë akademike, aktivitetet artistike, kulturore, sportive etj. **(F2.46) [Kreu III, Standardi VII.1].**

2.10 UART-ja ka një rrjet për transmetimin e teknologjisë së informacionit që është i përhapur në të gjithë pjesën e brendshme dhe të jashtme të godinave të kampusit dhe është i nevojshëm për menaxhimin e aktiviteteve mësimore dhe aktiviteteve të tjera studentore **(RVV, fq. 32, 33)**. Siç përmendet më lart, përveç Platformës Online bazuar në paketën e shërbimit *cloud* “Microsoft Office 365” e cila përdoret për zhvillimin në distancë të proceseve akademike të Universitetit të Arteve, gjatë muajit mars 2020, u zbatua dhe u vu në përdorim një platformë si pasojë e përhapjes së pandemisë. Në dispozicion të procesit mësimor dhe studentëve apo personelit akademik janë auditore me hapësira të bollshme, salla e shfaqjeve “Black-Box”, ku studentët eksperimentojnë me forma të ndryshme teatrale, e cila është e pajisur me kompjuter dhe infrastrukturë audio-vizuale në dhomën e kontrollit në shërbim të sistemit audio, dhe Salla e Koncerteve aktualisht në rikonstruksion **(BM3; BM4; BM5)**. Po kështu, për njësitë bazë dhe kryesore ka një rrjet laboratorësh dhe infrastrukturash të tjera **[Kreu III, Standardi VII.2].**

2.11 UART-ja ka disa godina të ndërlidhura ku ndodhen njësitë kryesore të tij duke përfshirë sallën “Black Box”, Galerinë FAB dhe amfiteatrin. Ndërkohë pritet të miratohet projekti i ndërtimit të Kampusit Universitar dhe pas ndërtimit pritet të nisnin punimet (Vizitë në objekt). Kjo sjell shqetësim për periudhën e tranzicionit, veçanërisht në lidhje me ruajtjen e materialeve dhe trashëgimisë kulturore. Universiteti ka regjistruar në mënyrë të detajuar pasuritë e paluajtshme **(F2.17)**. UART-ja, me urdhër të administratorit, ngre komisionin ad-hoc për monitorimin e pasurive. Ai krijon Komisionin për inventarizimin e pasurive të UART-sw. Me urdhër administratori përfshin kohëzgjatjen e periudhës së verifikimit dhe hartimit të raportit të inventarit. Në përfundim të verifikimit, Komisioni përgatit një raport për Administratorin e UART-së **(F2.18)**. Rikonstruksioni i plotë ka përfunduar kohët e fundit. Shpesh hapësirat dhe ambientet më të rëndësishme u jepën me qira institucioneve dhe strukturave të tjera me të cilat bashkëpunon dhe ndërvepron. **[Kreu III, Standardi VII.3].**

2.12 Procesi mësimor dhe akademik mbështetet nga Biblioteka shkencore e Universitetit të Arteve dhe sallat e tyre përkatëse (salla e hapur, salla e mbyllur dhe salla multimediale), dedikuar rektoratit dhe disa njësite kryesore të universitetit **(F5.11; F5.12; F5.13; F5.14)**. UART-ja siguron ruajtjen e trashëgimisë profesionale akademike në arkivin e Fakultetit të Arteve të Bukura si dhe në arkivin e studios së Skenografisë dhe Kostumografisë. Në Fakultetin

e Arteve Skenike bëhet ruajtja edhe në arkivin dixhital të programit të studimit Regji Filmi dhe TV. Institucioni ndjek një politikë të vlerësimit dhe zhvillimit të asetëve të tij akademike, kulturore dhe artistike-shkencore. Kjo bëhet nëpërmjet materialeve të ndryshme të ruajtura ndër vite të krijimtarisë artistike të këtyre fakulteteve (Vizitë në ambientet e institucionit). UART-ja ka një histori dhe arkiv të pasur vlerash akademike **(F4.5)**. **[Kreu III, Standardi VII.4]**.

2.13 Universiteti ka në dispozicion gjashtë godina, të cilat i janë nënshtruar rindërtimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të kushteve të tyre. Ndërtesa kryesore është me pamje nga sheshi "Nënë Tereza". Kjo godinë, së bashku me "Sallën e Koncerteve", e cila aktualisht është në rikonstruksion, janë projektuar nga arkitekti Gherardo Bossio në vitin 1939. Ndërtimi i tyre filloi në vitin 1939 dhe përfundoi në vitin 1942. Për rrjedhojë, dhe për vlerat arkitekturore që ka, kjo ndërtesë gëzon statusin "Monument Kulture i Kategorisë II" **(F2.19)**.

UART-ja ofron ambientet e mëposhtme për procesin akademik:

- Zyrë dhe Sallë mësuesish - 34
- Ambiente mësimore dhe studimore - 123
- Ambiente shërbimi - 20
- Ambiente komunikimi = 3050 m²
- Salla leksionesh - 2 me kapacitet 220 dhe 100 studentë
- Salla të tjera - 12, ndër të cilat evidentohen salla baleti dhe koreografie me sipërfaqe 100 m² dhe 110 m².
- Laboratorë dhe studio - 12
- Numri i përgjithshëm i ambienteve administrative - 16 zyra

Infrastruktura e UART përfshin gjithashtu:

- Sallë të madhe koncertesh me një kapacitet prej 600 vendesh
- Sallën "Black — Box" me kapacitet 220 vende
- Sallën "Ibrahim Madhi".
- Sallën "Çesk Zadeja" me sipërfaqe 189 m²
- Amfiteatrin veror me kapacitet 400 vendesh
- Bibliotekën shkencore me sipërfaqe 500 m² **(RVV, fq.36, 37) [Kreu III, Standardi VII.5, Kreu III, Standardi V.1]**.

2.14 Infrastruktura e UART është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për veprimtari mësimore, kërkimore, sociale dhe artistike. Në veçanti, hapësirat për studentët janë të përcaktuara dhe bashkë me ndërtesat e reja që janë aktualisht në rikonstruksion do të jenë të mjaftueshme (Vizitë në objekt). Për të përmbushur pritshmëritë dhe nevojat e studentëve dhe stafit UART kryen sondazhe periodike me studentët dhe stafin, ku ndër të tjera përfshihen edhe pyetje që lidhen me infrastrukturën. Rezultatet e anketës paraqiten në një raport i cili i

dërgohet Komisionit për Sigurinë e Cilësisë **(A.1.5; F4.11)**. **[Kreu III, Standardi VII.6]**

2.15 Të gjitha strukturave përbërëse të Universitetit të Arteve u shërben sistemi logjistik dhe administrativ, i cili garanton mbarëvajtjen e veprimtarisë mësimore, duke marrë të gjitha masat mbrojtëse të nevojshme për studentët, pedagogët dhe stafin asistent akademik. Fakultetet janë të pajisura me laboratorë të specializuar dhe çdo departament ka IT dhe laboratorët e vet kompjuterikë **(F2.20; F2.22; F2.23)**. Institucioni ofron shërbime sipas nevojave të tregut. Ndërmjet palës së interesuar dhe UART lidhet një kontratë në të cilën përcaktohen në mënyrë të detajuar të drejtat dhe detyrimet e ofruesit (UART) dhe të drejtat dhe detyrimet e përfituesit. Përfituesi i shërbimit ka të drejtë të paguajë detyrimet kontraktuale, të dorëzojë mjedisin në kushtet e ofruara, të kompensojë në rast dëmtimesh gjatë zhvillimit të aktivitetit (F2.20). Institucioni kryen anketa dhe vlerëson shërbimet logjistike duke i krahasuar me raste të ngjashme dhe mbi këtë bazë ndërton planin për ofrimin e shërbimeve të vazhdueshme. UART zotëron dokumentacion të plotë të veprimtarisë akademike në letër dhe në formë elektronike (Vizitë në ambientet e institucionit). **[Kreu III, Standardi V.2]**.

Gjetjet

Praktika e mirë

Grupi i vlerësimit të jashtëm identifikoi praktikat e mira të mëposhtme për këtë fushë vlerësimi:

- Iniciativat private nga menaxherët e artit, por edhe nga vetë pedagogët, artistë të cilët angazhojnë studentë të UART-sw në aktivitete sociale, kulturore dhe artistike **[Kreu III, Standardi IV.4]**

Pikat e dobëta

Grupi i vlerësimit të jashtëm nuk identifikoi pika të dobëta për këtë fushë vlerësimi.

Rekomandime

Grupi i vlerësimit të jashtëm nuk dha rekomandime për këtë fushë vlerësimi.

Konfirmimi i veprimeve të ndërmarra

Për këtë fushë vlerësimi, grupi i vlerësimit të jashtëm pohoi veprimin e mëposhtëm tashmë në proces e sipër:

- Projekti i ndërtimit të një kampusi të ri universitar në hapësirën aktuale të Universitetit është në pritje të miratimit, ndërsa punimet për ndërtimin e tij pritet të fillojnë menjëherë pas miratimit. **[Kreu III, Standardi VII.3]**

Gjykimi

Standardet për Burimet janë përmbushur plotësisht.

Fusha e vlerësimit 3: Kurrikula

- 3.1 UART-ja ofron programe studimi në dy cikle të studimeve universitare. Në mënyrë specifike, ai ofron 32 programe studimi të nivelit Bachelor, 27 programe studimi të nivelit Master i Arteve, 4 programe studimi të nivelit Master Profesional dhe 1 program studimi të nivelit Master i Shkencave. UART-ja ka aplikuar në MAS për hapjen e programeve të ciklit të tretë, për përfitimin e gradës shkencore “Doktor në Muzikologji” dhe “Doktor në Arte Skenike”, por ende nuk është marrë miratimi zyrtar. Fushat dhe programet e studimit janë në përputhje me kushtet e infrastrukturës që ka institucioni dhe në përputhje me strategjinë e tij. Programet e studimit njihen nga publiku, nga të diplomuarit e shkollës së mesme dhe nga të gjithë të interesuarit. Këto programe studimi janë të publikuara në faqen e internetit të universitetit dhe bëhen publike në të njëjtën kohë me zgjedhjet e disponueshme nga secili nivel institucional, njësi kryesore dhe njësi bazë (**F3.1; F3.2**). Universiteti i Arteve ndjek një politikë të hapur për konkurrentët që vijnë nga trojet shqip folëse. Për çdo vit akademik ka prurje konkurrentësh nga Kosova, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Presheva dhe Bujanovci. Për këta konkurrentë janë përdorur kuota të veçanta për çdo vend. Nga ana tjetër, disa prej anëtarëve të personelit akademik të të tri fakulteteve të UART-së kanë zhvilluar takime të vazhdueshme në shkollat e mesme me qëllim që t’u shpjegojnë programet e studimit, mënyrën e funksionimit dhe mundësitë që u ofron UART-ja studentëve të rinj të apasionuar pas artit, një trajnim artistik cilësor. Misioni i universitetit fokusohet në fushat e studimit për të cilat universiteti ofron programe studimi. Programet e studimit ndërtohen sipas logjikës dhe kërkesave të ligjit për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë. Programet hartohen duke respektuar ndarjen e ngarkesës mësimore për çdo program studimi në raport me lëndët bazë, lëndët plotësuese dhe lëndët specifike (karakteristike). Programet dhe dosja e tyre e plotë hartohen nga njësi bazë dhe miratohen sipas hierarkisë nga njësi kryesore dhe Senati Akademik (**F3.3; F3.4; F3.5; F3.6, 3.7; F3.8; F3.9**). [*Kreu I, Standardi I.1*].
- 3.2 Programet e studimit që ofron UART-ja janë hartuar në mënyrë të tillë që studentët dhe ish-studentët tashmë të diplomuar të kenë mundësi të vijnë me studime dhe kualifikime të mëtejshme. UART-ja nuk ofron programe të ciklit të arimit të vazhdueshëm. Nëse lind nevoja për këto programe, Universiteti i Arteve i ka mundësitë akademike dhe infrastrukturore për ofrimin e tyre. UART-ja ofron programe studimi me kohë të plotë në të dyja ciklet e studimit, Bachelor dhe Master. Megjithatë, bashkëpunimi me të diplomuarit dhe partnerët e jashtëm mund të përmirësohet në mënyrë që fokusi të jetë më shumë tek idetë dhe programet inovatore, të cilat mund të ndihmojnë në rritjen e mëtejshme të cilësisë. Në çdo rast, bashkëpunimi i universitetit me të diplomuarit e tij në këto fusha është i fortë dhe nevojat e tyre sa i përket mbështetjes artistike

plotësohen nga UART-ja në disa raste (**BM11**). Programet e studimit që ofron ai i shërbejnë studentëve për formimin artistik, profesional dhe shkencor në zhanret e muzikës, arteve skenike dhe arteve pamore. Programet e studimit të UART-së mbeten qendra më e madhe dhe me cilësinë më të lartë e arsimit universitar, pasuniversitar, kërkimit shkencor dhe trajnimit për përgatitjen profesionale të specialistëve në fushat e artit (**F1.7; F3.24**). *[Kreu I, Standardi I.2].*

3.3 UART-ja ka një strategji zhvillimi institucional për vitet 2018-2025, e cila është miratuar nga strukturat qeverisëse të universitetit (**F1.14**). Programet e studimit janë në përputhje me këtë strategji zhvillimi e cila, siç specifikohet në këtë strategji, synon një arsim të qëndrueshëm me kompetenca akademike të studentëve. Programet e studimit që ofrohen, përfshijnë të gjitha fushat artit që lidhen me tregun e punës dhe nivelet e kualifikimeve. Këto janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit të UART-së, statutit të UART-së, si edhe me Rregulloret e programeve të studimit të nivelit Bachelor dhe Master (**F1.1; F1.14; F3.10; F3.11**). Diploma që lëshon Universiteti i Arteve përcakton qartësisht ciklin e studimeve, si edhe titullin që i korrespondon programit të studimit për të cilin është regjistruar studenti sipas përkufizimeve në aktet nënligjore në fuqi (**F3.12; F3.13; F3.14; F3.15**). *[Kreu I, Standardi I.3].*

3.4 Programet e studimit të ofruara nga universiteti janë në përputhje me objektivat kombëtare të arsimit të lartë dhe me drejtimet e përgjithshme kombëtare të zhvillimit shoqëror-ekonomik të vendit. Ky objektivi i programeve të studimit shërben edhe për të përmbushur një sërë kërkesash të cilat janë diktuar nga fusha ku vepron institucioni dhe tregu shqiptar i artit. Ndër të tjera, si objektivi strategjik, universiteti parashikon t'i aftësojë studentët të jenë më konkurrues në tregun e punës pas diplomimit të tyre dhe t'u ofrojë fleksibilitet të mjaftueshëm për zhvillimet në të ardhmen dhe t'u përshtaten kushteve që ndryshojnë. Programet e studimit janë edhe shumëdisiplinare, dhe një gjë e tillë konsiderohet një pikë e fortë e veçantisë së universitetit (**F1.17; F3.1**). Për çdo program studimi, në të dyja ciklet e studimit, gjuha e huaj është pjesë e kurrikulës, me qëllim që studentët të fitojnë kompetencat që lidhen me përdorimin e terminologjisë profesionale dhe njohurive mbi të. Në Universitetin e Arteve janë zhvilluar dy gjuhë të huaja bazë, gjuha angleze dhe frënge. Në programe studimi të veçanta mësohen, gjithashtu, gjuha italiane dhe gjermane (**RVV, fq. 49; BM5**). *[Kreu I, Standardi I.4].*

3.5 Programet e studimit mbështeten nga kapacitetet e institucioneve që janë të një natyre akademike, infrastrukturore, metodike dhe tradicionale. Personeli akademik i UART-së ka një ndarje të kohës së angazhimit mes procesit mësimor dhe veprimtarisë artistike (**F3.16; F3.17**). Personeli akademik me kohë të plotë mund ta tejkalojë normën vjetore të mësimdhënies deri në 200 orë mësimore mbi ngarkesën e detyrueshme vjetore, pas përfundimit të të

gjitha detyrimeve vjetore (ngarkesë pune intelektuale/ akademike). Orët shtesë mbi normë paguhen nga të ardhurat dytësore universitetit. Shpërndarja e ngarkesës mësimore për anëtarët akademikë të brendshëm të departamentit realizohet duke respektuar kurrikulën e çdo programi studimi me qëllim që të sigurohet harmonizimi i ngarkesës mësimore, punës kërkimore shkencore dhe angazhimeve administrative **(F3.17) [Kreu I, Standardi I.5]**.

- 3.6 Programet e studimit promovohen nga UART-ja. Janë të kuptueshme, të qarta dhe studentët marrin informacion të plotë rreth përmbajtjes së tyre. Studentët kanë mundësinë të përzgjedhin dhe të krahasojnë programet e studimit të ofruara nga UART-ja dhe institucione të tjera të arsimit të lartë, dhe jashtë shtetit, gjithashtu. Secili program studimi ka objektiva të qarta dhe përshkruan tërësinë e njohurive dhe kompetencave të përfuara nga një student i cili regjistrohet dhe ndjek programet e studimit **(F3.1) [Kreu I, Standardi I.6]**.
- 3.7 Programet e studimeve universitare janë të organizuara me 180 kredite, me kohëzgjatje tri vjeçare, në përputhje me praktikën universitare në zonën e Bolonjës dhe asaj të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë. Këto programe studimi u japin studentëve të drejtën të vazhdojnë studimet më tej të një niveli më të lartë studimesh në të njëjtin universitet, ose në institucione të tjera të arsimit të lartë, brenda ose jashtë vendit **(F3.1; F3.10; F3.12)**. Qëllimi është pajisja me njohuri bazë për metodat profesionale artistike dhe / ose shkencore, parimet e përgjithshme artistike dhe formimin e aftësive të veçanta në fushën e muzikës, arteve skenike dhe arteve pamore. Ndarja e lëndëve sipas çdo programi bëhet në përputhje të plotë me kërkesat e Vendimit nr. 41, të datës 24.1.2018 të Këshillit të Ministrave, duke marrë parasysh edhe orientimin e veçantë të lëndëve të arteve dhe nevojat, gjithashtu. **(F1.3)**. Programet e studimeve universitare (Bachelor) janë të krahasueshme, gjithashtu, me programe të ngjashme në institucione të tjera të arsimit të lartë dhe jashtë shtetit, gjithashtu, dhe kjo lehtëson transferimin e studimeve në çdo universitet tjetër. **[Kreu I, Standardi I.7]**.
- 3.8 UART-ja ndjek një politikë që i ndihmon studentët të përshtaten me programet e studimit dhe mjediset e universitetit. Strukturat e krijuara në nivelin universitar në shërbim të studentëve dhe për kurrikulën e shkollës kanë në fokusin e tyre përshtatjen dhe përvetësimin ose integrimin e lehtë të studentëve në karrierën akademike. Universiteti i Arteve ndjek një politikë mbështetëse për studentët me aftësi të kufizuara. Për këtë kategori, në bazë të ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi, kriteret për fitimin e bursave përcaktohen në bazë të kategorive përkatëse, të cilat ndryshojnë çdo vit akademik. Kjo kategori përfiton nga bursat në masën 100% ose 50% **(F5.8; F5.9)**. Studentët e vitit të parë këshillohen lidhur me mënyrën se si t'i përdorin ambientet studentore dhe ambientet akademike, instrumentet artistike, labororët, si të kenë akses në bibliotekë, në sistemet e informacionit, si të komunikojnë me pedagogët dhe sekretarët, dhe

si të informohen lidhur me aktivitetet studentore dhe aktivitete të tjera, vlerësimin e njohurive dhe procedurat e regjistrimit, etj. **(F5.2)**. Ngjitur me çdo njësi kryesore ndodhet një zyrë studentore e cila i udhëzon dhe i ndihmon studentët. Ndërkohë, personeli akademik përdor edhe forma të tjera interaktive të mësimdhënies të cilat lehtësojnë dhe ndihmojnë integrimin e studentëve. UART-ja e rekruton stafin e tij akademik në bazë të nevojave dhe kërkesave për çdo program studimi. Personeli akademik me kohë të plotë arrin të realizojë 78.5% të orëve në total të programeve të studimit, kurse personeli akademik i ftuar realizon 21.5% të këtyre orëve në total **[Kreu I, Standardi I.8]**.

3.9 UART-ja përpiqet të angazhojë profesionistët me të mirë e më të shquar të fushës. Stafi me grada e tituj akademikë mbetet i rëndësishëm, por në disa fusha kjo nuk është përparësi për shkak të lëndëve specifike dhe statusit të veçantë të UART-së (VKM nr. 145/2021 "Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Arteve si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e artit në Republikën e Shqipërisë") **(F1.3)**. Programet e studimit për ciklin e dytë "Master i Shkencave", "Master i Arteve" dhe "Master Profesional" janë të organizuara në dy vite akademike. Këto programe studimi ofrojnë formim artistik, si psh studime në fushën e mësimdhënies, duke iu mundësuar studentëve të drejtën për punësim si mësues të lëndëve të artit në klasat e parashkollorit, në shkollat fillore (9 vjeçare) dhe shkollat e mesme. Studentët duhet të kenë grumbulluar 120 kredite për gradën MA ose MSc dhe 60 për MP. Programet e studimit janë të organizuara në module dhe vlerësohen me kredite (ECTS). Diploma që merret për çdo program studimi në UART për ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë është efikase për kalimin progresiv të studentit nga cikli i dytë në ciklin e tretë të studimeve doktoale. Në hartimin e kurrikulës, njohuritë paraprake të fituara nga studenti nga cikli i parë i studimeve Bachelor konsiderohen relevante. Kurrikula ndërtohet duke respektuar rregulloren e programit të studimit **(F3.11)**. personeli akademik me kohë të plotë arrin të realizojë 78.5% të orëve në total të programeve të studimit, kurse personeli akademik me kohë të pjesshme realizon 21.5% të këtyre orëve **(F3.18) [Kreu I, Standardi I.9]**.

3.10 Të gjitha programet e studimit, të nivelit të parë (universitare), të nivelit të dytë (Master) dhe në pritje të miratimit për hapjen e 2 (dy) programeve doktoare, ofruar nga UART-ja janë në përputhje me procesin e Bolonjës dhe kjo lehtëson dhe ndihmon mobilitetin e studentëve shqiptarë të këtij universiteti në institucione të tjera të arsimit të lartë në Europë dhe më gjerë. Ky ndryshim dhe rregullim parashikohet edhe në dokumentet kryesore të UART-së, të tilla si Statuti dhe rregullorja e brendshme e UART-së. Çdo program shprehet me orë dhe kredite sipas modelit European **(F3.9, nga a tek d)**. Suplementi i Diplomës për të gjitha programet e studimit të UART-së përgatitet dhe formulohet në dy gjuhë, në gjuhën shqipe dhe angleze. Së bashku me këto dy dokumente, studenti i diplomuar merr listën e notave për periudhën e studimeve të

përfunduara (**F3.12; F3.13; F3.14; F3.15**). UART-ja ka një numër të madh marrëveshjesh bashkëpunimi me universitete të tjera të vendeve të huaja, kryesisht europiane dhe të tjera. Transferimi i studimeve është lehtësisht i zbatueshëm në UART (**F1.18; F1.19; F1.20**) [**Kreu I, Standardi I.10**].

3.11 Programet e studimit kanë orë në dispozicion për praktikë, teori, ushtrime, punë në laborator dhe detyra të tjera kursi apo punë të pavarur. Programet e studimit në UART janë organizuar duke marrë parasysh natyrën shumë specifike të institucionit tonë, në mënyrë të tillë që të krijohen ambiente për studim për të dy ciklet. Në shumë lëndë, modaliteti mësimor është individual për çdo student. Kjo mënyrë mësimdhënieje krijon mundësinë për të realizuar në praktikë njohuritë artistike, teorike dhe praktike të përvetësuara gjatë orëve mësimore (**F1.15; F4.3; BM5**). Praktika profesionale dhe praktika mësimore është pjesë e kurrikulës dhe përmban një numër të caktuar kreditesh, ndërkohë që studentëve u kërkohet ta kryejnë atë. Teza e diplomës është një punë e pavarur dhe krijuese e studentit në formën e një programi/projekti artistik ose një studim i përgjithshëm në programin e studimit të përfunduar (**F3.10; F3.11**) [**Kreu I, Standardi I.11**].

3.12 Programet e studimit janë hartuar duke u mbështetur në kriteret e Vendimit 41 të Këshillit të Ministrave, të datës 24.01.2018, sipas të cilit në çdo program ka lëndë specifike (karakteristike) të cilat ofrojnë trajnimin e nevojshëm profesional, në të cilin studentët fitojnë nga 90 në 99 kredite, ose 50-55% të krediteve në total. Zhvillimi i kurrikulës është në përputhje me institucionet simotra në vendet e tjera me qëllim që të lehtësohet hyrja e studentëve në tregun ndërkombëtar të punës (**F3.24**). [**Kreu I, Standardi I.12**].

Gjetjet

Praktika e mirë

Grupi i vlerësimit nuk identifikoi tipare të praktikës së mirë për këtë fushë vlerësimi.

Pikat e dobëta

Grupi i vlerësimit nuk identifikoi pika të dobëta për këtë fushë vlerësimi.

Rekomandime

Grupi i vlerësimit dha rekomandimet e mëposhtme:

- Edhe pse institucioni ka komunikim dhe bashkëpunim të mirë me të diplomuarit dhe partnerët e jashtëm, bashkëpunimi me këto të fundit mund të përmirësohet me qëllim që fokusi të jetë më shumë te idetë inovative dhe te programet që mund të ndihmojnë për të rritur më tej cilësinë dhe konkurrueshmërinë e UART-së **[Kreu I, Standardi I.2]**.

Konfirmimi i veprimeve të ndërmarra

Për këtë fushë vlerësimin grupi i vlerësimit të jashtëm pohoi veprimin e mëposhtëm tashmë në proces e sipër:

- UART-ja ka aplikuar tek MAS për hapjen e programeve të ciklit të tretë, Doktor në Muzikologji dhe Doktor në Artet Skenike, por akoma nuk është miratuar zyrtarisht nga MAS. **[Kreu I, Standardi I.1]**

Gjykimi

Standardet për Kurrikulën janë përmbushur plotësisht.

Fusha e vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi Shkencor

- 4.1 Programet e studimit bazohen në kuadrin ligjor dhe rregulloret për institucionet e arsimit të lartë **(RVV, fq. 59)**. UART-ja ofron programe studimi të një natyre specifike **(F4.1)**. Departamentet i rishikojnë në mënyrë periodike programet e studimit, kurrikulat dhe propozojnë ndryshime që miratohen në fund nga Senati Akademik **(F4.2)**. Personeli akademik punon i organizuar në grupe për të përmirësuar përmbajtjen e kurrikulës dhe programeve lëndore **(RVV, fq. 59)**. Studentët udhëzohen dhe mbikëqyren gjatë praktikës. UART-ja ka kapacitete të mjaftueshme për të zhvilluar praktikën nëpërmjet institucioneve të ndryshme publike dhe private, për shkak të numrit të madh të marrëveshjeve të partneritetit që ka. Studentët udhëzohen dhe mbikëqyren gjatë praktikave, stazheve **(F4.3)** dhe përgatitjes së diplomës nga personeli akademik në përputhje me procedurat specifike **(RVV, fq. 60)**. Universiteti ka bibliotekë fizike dhe elektronike **(F4.5)** të cilat i plotësojnë kërkesat e personelit akademik dhe të studentëve **(BM3; BM4; BM5; BM6)**. *[Kreu I, Standardi II.1].*
- 4.2 Rregullat dhe kërkesat e vlerësimit janë shprehur në rregulloret e UART-së **(F3.10; F3.11)**, si edhe modalitetet e vlerësimit shprehen qartë në programet lëndore **(F4.1)**. Procedurat dhe kriteret e diplomimit përcaktohen qartë në rregulloren e UART-së dhe rregulloret e programeve të studimit **(F3.10; F3.11)**. Ankesat lidhur me rezultatet e provimeve dhe procedura për përmirësimin e notës janë në përputhje me rregulloren e UART-së **(F4.8; F3.11)**. Studentët kanë një llogari personale e cila u jep akses për të parë rezultatet e provimeve, duke respektuar parimin e konfidencialitetit **(F4.9)**. Anonimiteti respektohet gjatë korrigjimit të provimeve. Nota u dërgohet studentëve nga pedagogu nëpërmjet sistemit ESSE dhe nuk u shpallet sekretarive të fakulteteve për të ruajtur konfidencialitetin e studentit. Në rastet e kontrollit me shkrim, përdoret sistemi i vlerësimit me pikë dhe rezultatet kthehen në notë. Provimet bëhen me sekretim **(RVV, fq. 62; BM3; BM4)** *[Kreu I, Standardi II.2].*
- 4.3 Rezultatet e konkurseve të pranimit u shpallen sekretarive mësimore në rend zbritës dhe publikohen në faqen e internetit të UART-së, gjithnjë duke respektuar konfidencialitetin e të dhënave. UART-ja vlerëson një herë në vit veprimtarinë mësimore-artistike dhe shkencore të personelit akademik **(F1.15)** sipas politikave të veta **(F4.10)**. Personeli akademik, programet e studimit, burimet logjistike dhe burime të tjera vlerësohen nga studentët nëpërmjet sondazhit ose pyetësorëve **(F4.11)**. Programet e studimit rishikohen dhe përmirësohen në mënyrë periodike me qëllim që të rritet cilësia, duke përdorur vlerësimin e vitit të mëparshëm akademik, çka është në përputhje me rregulloret e UART-së **(F3.10; F3.11)**. Të dhënat për punësimin e studentëve në vend dhe jashtë shtetit në institucione prestigjioze nënkuptojnë cilësinë e

